33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimin përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektit dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 **"Force Madhore"** siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktojnë jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përipiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	Emri i Autoritetit Kontraktues: Komuna e Rahovecit me adresë në rrugën "Xhelal Hajda – Toni" të cilën e përfaqëson Menaxheri i Prokurimit: Jetulla Kabashi dhe Emri i Kontraktuesit: N.P.N. "EUROING" me adresë në Rahovec, të cilën e përfaqëson Kujtim Thaqi janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë: TITULLI I KONTRATËS: FAZA E TRETË - NDËRTIMI I PALESTRËS SPORTIVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT Numri i Prokurimit: 623-18-3302-5-1-1 Numri i Brendshëm: 623-18-025-5-1-1
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	10% i ndalet një vit pas pranimit teknik të punimeve. Pagesa e shumës së ndalur ne emer te sigurimit te punimeve (10%) mund të i paguhet: Operatorit Ekonomik me : a. Vendim të Kryetarit të Komunës për leshimin e pageses së 10% te ndalur ne emer te sigurimit te punimeve dhe b. Nese OE e sjell garancionin nga ndonje kompani e licencuar e sigurimeve ose nga ndonjë bankë (për periudhen për të cilën edhe është ndalur 10%). Pagesat kontraktuesit do t'i bëhet në bazë të raportit të organit mbikqyrës.
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda [5] ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [5] ditë


Inspektimi dhe testimi	9.1	Organi Mbykqyrës është: Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve te përgjithshme te kontratës.
Fillimi i punëve	10.1	Punët do te fillojnë brenda Pesë [5] dite pune pas ftesës nga autoriteti kontraktues përkatësisht nga ana e organit mbikëqyrës ose menaxheri i projektit. Ftesa për fillim te punëve do te behet me krijimin e kushteve atmosferike.
	10.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonesave të lejuara nga organi mbykqyrës. Kontrata është: 65 ditë pune.
Përmirësimi i defekteve	13.1	Periodha garantuese e defekteve është: 12 muaj.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë: Sipas Kushteve te përgjithshme te kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë/realizoj ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, punëdhënësi, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.
Parapagimi	20.1	Shuma e Parapagimit është: nuk aplikohet.
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: [shëno përqindjen]
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës = 62,854.52 €
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve. Pagesa do te behet vetëm për punët e përfunduara sipas raportit te organit mbikëqyrës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	Autoriteti kontraktues cakton departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Gjakovë – Dega Rahovec] në pajtim me ligjin në Kosovë.

	Objekti : Ndertimi I palestres sportive				
	Investitor: Ministria per Kulturë Rini dhe Sport				
	Lokacioni : Rahovec				
1	Gjendja e ofertuar				
	Punet paraprake	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	SHUMA
1.1	Punet pergaditore duke perfshire pastrimin, stacionimin dhe rrethimin e objektit	komplet	1	100.00 €	100.00
1.2	Furnizimi ,regjistrimi dhe montimi I ores se rrymes per furnizim gjate punimeve	komplet	1	1,500.00 €	1,500.00
	gjithesej per punet paraprake				1,600.00
2	Punet e dheut dhe te mbushjes me tampon				
2.1	Furnizimi dhe Mbushja e terenit ne tere hapsiren e lire rreth salles edhe ne pjesen veriore te objektit ..mbushja me tampon zhavorë trashesia e shtreses d~1.5m.. Ngjeshja me mekanizem cilindër , deri ne shkallen prej 6kN/cm2	m3	1500	3.50 €	5,250.00
2.2	Furnizimi dhe montimi I konuseve nga betoni me diameter Ø1000	cope	9	18.00 €	162.00
					5,412.00
3	Punet e murit te jashtem				
3.1	Furnizimi dhe montimi I coklles nga betoni C25/30 me lartesi 40cm pergjat perimetrit te salles me trashesi 25cm	m'	140	10.00 €	1,400.00
3.2	Furnizimi, sivatimi dhe ngjyrosja e murit rrethues pergjate perimetrit te objektit me ngjyre plastike te rezistueshme ndaj kushteve atmosferike	m'	140	0.30 €	42.00
	gjithesej per punet e murit rrethues				1,442.00
4	Konstruksionet metalike dhe mbulesa				
4.1	Furnizimi pastrimi dhe ngjyrosja ne dy shtresa dy perfundimtaree tere konstrukcionit deri ne miratimin e organit mbikqyres. Në çmim te llogaritet edhe ngritja e skelerise brenda salles pasi qe lartesia e punes behet ne lartesi prej H=15M . Çmimi te jipet per kg	kg	187000	0.10 €	18,700.00
4.2	Furnizimi dhe montimi I mbyllesave nga pllakat metalike me dimensione 250x200x10mm ne fund te kapriatave ne menyre qe te pengohet futja e ujit dhe shpezeve. (SKELERIA E DOMOSDOSHME PASI QE LARTESIA ESHTË 20M)	COPE	60	25.00 €	1,500.00
4.3	Furnizimi dhe montimi I mbyllesave nga pllakat metalike me dimensione 200x150x10mm ne profilat e pjerrte ta fasades per largimin e ujit. (SKELERIA E DOMOSDOSHME PASI QE LARTESIA ESHTË 20M)	COPE	30	30.00 €	900.00

4.4	Prerja e profilave nga metali dhe largimi i tyre me kujdes te madh pasi qe lartesia eshte mbi 20 m lartesi .(DUHAT TE PARASHIHET SKELERIA) Dimensionet e profilave 200x100x8mm) dhe gjatesi 5m	COPE	30	10.00 €	300.00
4.5	Furnizimi dhe intervenimi per mbylljen e te gjitha hapjeve te mbetura ne depertimet e profilave metalik te pjerret neper panelet vertikale me purpen dhe te finalizohet me kujdes	COPE	80	40.00 €	3,200.00
4.6	Intervenimi dhe izolimi i vijave te fasades strukturale ne vendet ku ndodhen xhamat prizmatik me fuge silikate te rezistueshme ndaj plasaritjeve dhe ndryshimeve temperaturale	m	950	0.10 €	95.00
4.7	Furnizimi dhe mveshja e pllafonit te kulmit me pllafon te varur ne pjeset e jashtme per mbrojtjen pullazit nga ndikimet e eres.Mveshja te parashihet me sandwich panel 5cm .Ne çmim te llogaritet konstrukcioni i çelikut i varur per montimin e panelit	m	1390	1.00 €	1,390.00
5	sitemi i olluqeve horizontale edhe atyre vertikale formohet prej te njejt material sikurse edhe mbulesa e kulmit me sistemet e sigurise edhe konstruksionin perkates mbajtes se ketyre elementeve te ventosura ne çdo 1m' ,materjali çelik				
5.1	horizontal dim.26*40*26 cm	m'	120	7.00 €	840.00
5.2	vertikal dim.26*26cm	m'	35	7.00 €	245.00
5.4	Elementet mbi edhe nen dritare nga nana e jashtme edhe e mbrendeshme te salles, element nga llamarina i profiluar si ne prerjet e paraqitura me profil 26.5+55+60	m'	160	5.00 €	800.00
	gjithesej pere punet e konstruksionit edhe mbuleses				27,970.00
6	Nivelizimi dhe rrafshimi i siperfaqeve horizontale				
6.1	rrafshimi dhe nivelizimi i shkalleve te jashtme si dhe atyre te mbrendeshme,shkalleve per zbritje nga tribunat, behet me Estrih beton i armuar me rrejt metalike ne shtrese prej 4~6cm dhe ate vetem pjeset horizontale si dhe intervenimi me lyerje te pjeseve vertikale				
	shkallet e mbrendeshme	m²	120	20.00 €	2,400.00
	shkallet e jashtme	m²	50	25.00 €	1,250.00
6.2	Furnizimi dhe mveshja e shkalleve me granit te klasit të parë 3 cm flakeruar kunder rreshqitjes				
	shkallet e mbrendeshme	m²	120	200.00 €	24,000.00
	shkallet e jashtme	m²	50	200.00 €	10,000.00
	gjithesej pere rrafshimin dhe nivelizimin e siperfaqeve				37,650.00
7	Hidroizolimet				
7.1	Furnizimi dhe punimi me Hidroizolim "hidrozol" dy komponentesh pere nyjet sanitare ku psraprakisht të bëhet pastrimi dhe tharja e terenit ku do të vendoset hidroizolimi si dhe pjeset vertikale deri në 30 cm.				


	suteren	m ²	187	20.00 €	3,740.00
	<i>gjithesej pere hidrozol 2 komp.</i>				3,740.00
8	Furnizimi dhe mveshja e mureve dhe dysHEMEVE të garderobave, toaleteve, banjove me pllaka prej keramike të klasit të parë. Ngjitja të bëhet me ngjitës dhe fugë. Hidroizolimi (mbi suvatim) "ARDEX" ARDULAN 8+9 i cili ngritet edhe në mure min 40 cm nga dyshmea. (ose i ngjajshëm me kualitet të njejt). Ngjitësi i pllakave "ARDEX" DIE ERFOLGSFORMEL X7G (ose i ngjajshëm me kualitet të njejt). Fuga e pllakave "ARDEX" ARDURIT FS DUSCHDICHT brillantweib, (ose i ngjajshëm me kualitet të njejt) ngjyra të përcaktohet nga projektanti. Në përfundim të punës pllakat të pastrohen dhe të fshihen. Dezeni dhe dimensionit i keramikës të caktohet sipas udhëzimeve të projektuesit. Llogarimi në m ² së sipërfaqës së mvëshur me pllaka keramike.				
	<i>posicionet jane te gjitha banjot dhe nyjet sanitare ne garderobera dhe lokale mbrenda objektit</i>				
	suteren	m ²	1800	15.00 €	27,000.00
	perdhese	m ²	1047	12.00 €	12,564.00
	kat	m ²	75	30.00 €	2,250.00
8.1	<i>muret me pll.ceramike</i>				
	<i>Pozicionet jane te gjitha banjot dhe nyjet sanitare ne garderobera , lokale</i>	m ²	1150	16.00 €	18,400.00
	<i>pere pll.ceramike totali</i>				60,214.00
9	<i>Paisjet Sportive dhe Parketi</i>				
9.1	Furnizimi me material dhe punimi i dyshemesë elastik (sportive) të fushëlojës me parket 12.6mm dru shumështrësor i cili duhet të plotësoi kërkesat e standardit DIN V standard 18032-2; EN 14904, FIBA rules 2010, dhe kontrollit të cilësisë RAL GZ 942, punohet me shtresat: -folie difuzive 200gr/m ² , t=2mm (nga poshtë) - trarë druri elastik t=3.7 cm, ne distance aksiale 50cm, - kontra traje-listella t=1.7 cm, ne distance aks. 13.7cm, -PE folie, -parket druri të lameluar t=1,26cm (final). Kjo dysheme duhet të jete për terrene sportive të brendshme dhe të plotësojë të gjitha normat sportive dhe teknike të kërkuara sipas: IHF, FIBA dhe BWF dhe standardet teknike dhe kualitetit të certifikuar sipas DIN, ISO 9001, ISO 14001 (parketi dhe nen-konstruksioni duhet të jete nga i njëjti prodhues prodhues - i certifikuar). Dyshemeja të punohet edhe me këndore-lajsne perimetrike me sistem ajrim të montuara në mure, mbulimi i pragjeve-dilatimeve me lajsne-fuge alumini. Në çmim dhe montim të parashihen të gjitha punët e nevojshëm për kompletimin e kësaj dyshemeje me material dhe ekzekutim të punëve sipas standardeve të lartcekura. Llogarite në metër katror të montuar,garancioni duhet të jetë 10 vjeçar.	m ²	1530	50.00 €	76,500.00

9.2	Furnizimi dhe montimi i ulseve për tribunat statike për spektator nga konstruksioni i zinkuar ose aluminit dhe ulëse të plastikës të qëndrueshme në goditje, të ken ateste kunder vandalizmit, Forma e ulëses: Ana frontale e drejtë dhe e lakuar te gjunjët e rehatshme, Kullimin e ujit (65 x 38 mm) , fiksion si në skemë nga Z-këndi, te shenjezuara me shenjen GS -kriterin e vleresimit dhe qertifikimit të siguris. Dimenzionet • Gjerësia e ulëses 450 mm • Thellësia e ulëses 410 mm • Lartësia e mbështetëses 320 mm • Lartësia e pëgjithëshme 400 mm Të dhënat teknike • Prej Polyamid i(PA) • Antizjarr sipas B1 ,DIN 4102/B1 • Te qëndrueshme ndaj UV- rrezatimi kushteve klimatike • Perzgjedhja e ngjyres sipas RAL • E punuar me injektim	copë	1900.00	13.50	25,650.00
9.3	Livrimi dhe montimi i konstruksioneve të basketbollit (lëvizëse-paluese) për fushlojërat ndihmëse nga prodhuesi si BENZ (ose i ngjajshëm me kualitet të njejtë).	copë	2.00	1500.00	3,000.00
9.4	Furnizimi dhe montimi i rrjetës ansore nga PVC litari me trashësi 4.2mm, hapja e rrjetës 8.0x8.0 cm lartësi standarde 8.00 m e varur në litarin /kavon / e celikut /në të tri anët e palestrës Në çmim hyn montimi komplet i rrjetës.	m ²	600.00	3.00	1,800.00
9.5	Furnizimi dhe montimi i "qaurave" për fiksionin e mbajtësve të rrjetës për voleboll. Në çmim të parashifet edhe mbulimi (kapaku) i "qaurës" me material të njejt sikur se dyshemea.	copë	2.00	40.00	80.00
9.6	Furnizimi dhe montimi i portave lëvizëse të hendbollit nga alumini me thellësi 140 cm; me rrjetë dhe me përforsim tokësorë. Garnitura duhet të përmbajë: :Portat e aluminit; konstruksioni palues i zinkuar, rrjetën për hendboll (naylon - fi 4mm). Portat te jene sipas standardeve SIST EN 749.Dhe te kene certifikaten IHF.Shtyllat e aluminit për hendboll.Konstruksioni palues nga hekuri me thellesi 140 cm.Rrjeta për IHF portat - naylon fi 4 mm.Perdja për rrjetën e hendbollit fi 4 mm.Perforcimi i portave për hendboll.	copë	2.00	1000.00	2,000.00



Handwritten signature

9.7	Furnizimi i konstrukcionit lëviz garues të basketbollit - projektioni 325 cm. Të ketë mundësinë e lëvizjes së lartësisë së unazës/rrethit nga 305 cm - 260 cm. Sistem duhet te përfshijë: pllakëzat e xhamit, unazën/rrethin dhe rrjetën. Tapaciri i përparëm me trashësi 15 mm. Të ketë mundësinë e rregullimit të lartësisë dhe pjerrtësisë së tabelës. Pozicionet "LOJË" dhe "PUSHIM" të rregullohen nëpërmes pompës mekanike hidraulike. Shpejtësia e levizjes së tabelës të jetë e mundshme të rregullohet nëpërmes rregullatorit. Të jetë ngjyrosur me ngjyrë metalike, nyjet dhe lidhesët të jenë të vendosura në kushineta sferike (lëvizese dhe me shkallë shume te ulet te fërkimit). Lëvizja e konstrukcionit të mundësohet nepermes 4 rrotave, 2 të fiksuara dhe 2 levizëse të cilat ngriten dhe uljen. Sistemi të përmbajë edhe pllakëzat e mbrapme për tu perforcuar në dyshe. Dimensionet ne pozicion te mbyllur: 475x210x190 cm. Sistemi të jete i aprovuar nga FIBA level 1 per gara nderkombetare.	copë	2.00	2500.00	5,000.00
9.8	Furnizimi dhe montimi i garniturës garuese për lojën e voleybollit. Garnitura duhet te permbajë: shtyllat e aluminit fi 100 mm, lartësia 3 m, me mekanizëm për tërheqje; mbrojtëset e shtyllave; bazamenti fi 100 mm; rrjetën garuese per voleyboll; mekanizmin për tërheqjen e rrjetes si dhe karrigën e gjyqtarit. Garnitura te jetë sipas standardeve SIST EN 1271.	copë	1.00	2302.00	2,302.00
9.9	Furnizimi dhe montimi i ulëseve metalike per garderoba - gjatesia 10 m. Uleset te kene konstrukcion metalik, ulje nga druri, dhe podiumin per paisje sportive (qanta etj). Ulesja te permbaje varrëse ne forme ergonomike në pjesen e pasme - lartë.	copë	4.00	350.00	1,400.00
9.1	Furnizimi dhe montimi i ulëseve metalike per garderoba - gjatesia 3.6 m. Uleset te kene konstrukcion metalik, ulje nga druri, dhe podiumin per paisje sportive (qanta etj). Ulesja te permbaje varrëse ne forme ergonomike në pjesen e pasme - lartë.	copë	3.00	200.00	600.00
9.11	Furnizimi dhe montimi i ulëseve metalike per garderoba - gjatesia 4 m. Uleset te kene konstrukcion metalik, ulje nga druri, dhe podiumin per paisje sportive (qanta etj). Ulesja te permbaje varrëse ne forme ergonomike në pjesen e pasme - lartë.	copë	3.00	150.0	450.00
9.12	Furnizimi dhe montimi i tavolines levizes te gjyqtarit me gjatesi 200 cm thellesi 76 cm. Tavolina i ka te instaluar rrotat. Ngjyra e tavolines hiri.	copë	3.00	50.0	150.00



[Handwritten signature]

INVESTITOR : MINISTRIA E KULTURES RINISE DHE SPORTEVE

9.13	Furnizimi dhe montimi i semaforit / tabelës së rezultateve. Paisja të ketë xhamin nga policarbonati antirefleks, i qëndrueshem nga goditjet e topave. DETAJET TEKNIKE: Dimensionet: 300 x 150 x 7 cm; Materiali: tabela e plastifikuar e aluminit; Peshë: 90 kg; Nderprerësi elektrik: 110/220 VAC - 50/60 Hz; Sirena, 118 dB; Tastiera me LCD ekran; Ruajtja e shënimeve në rast se vjen deri te ndërprerja e energjisë elektrike (bateritë janë te nevojshme). Te jete ne pajtueshmeri me standardet Electro dhe Elektromagnetike (EC dhe EMC). Të parashihet bartja kabllorike dhe radio e shënimeve, matja dhe numrimi i kohës, sirena automatike dhe e dorës e programuar sipas rregullave zyrtare për sportet: basketboll, voleyboll, hendboll dhe futboll. Semafori duhet të tregojë: KOHEN - 99:99, minuta e fundit në 1/10 e sekondit, lartësia / dimensionit i numrave - 25 cm, ngjyra e gjelbër; REZULLTATI - nga 0-199, lartësia / dimensionit i numrave 25 cm, ngjyra e kuqel; PERIUDHA: lartësia / dimensionit i numrave 18 cm, ngjyra e verdhë; GABIMET e ekipeve në basketboll - lartësia / dimensionit: 18 cm, ngjyra e verdhë; GABIMET E LOJTAREVE në basketboll - lartësia / dimensionit: 3 cm, ngjyra: gjelbert - e fundit e kuqe; LARGIMI I DY LOJETAREVE në hendboll - lartësia / dimensionit: 15 cm, ngjyra e kuqe; NUMRI I LOJETAREVE TE LARGUAR në hendboll - lartësia / dimensionit: 15 cm, ngjyra e verdhë; PARAQITJA E 5 SETEVE	copë	2.00	1000.0	2,000.00
9.14	KOHA E AKSIONIT Paraqitja e semaforit: koha e akcionit 0 – 99 sekonda, lartësia 25 cm, e kuqe, koha e lojës: 99:59 minut, lartësia 15 cm, e verdhë pika e sondazhit 8 cm, ndizet me aktivizimin e sirenes, e kuqe, koha e time outit. Informatat teknike dimensionet: 65 x 60 x 7 cm, materiali: tabela e plastifikuar e kallajit peshë: 8 kg, nderprerësi elektrik: 110/220 VAC - 50/60 Hz, sirena, aktivizimi automatik i sirenes në 00, pa furnizim shtese semafori është i mbrojtur nga goditjet e topave	copë	2.00	750.0	1,500.00
12					122,432.00
	Furnizimi dhe punimi i dyshemeve të tribunave me EPOKSIT si StoPOX KU101 me këto shtresa: 1. Vendoset shtresa e parë për rrafshim dhe njëkohësisht kryhet impregnimi (grundimi) në gjithë sipërfaqen, ku me këtë rast edhe mbyllet të gjitha fugat apo të plasariturat dhe këtu përdorim StoPox 452 EP. A+B. 2. Shtrirja e sipërfaqes mbuluese bëhet me StoPox KU101 komponenta A+B në përzierje me StoQuarz 0.1-0.2mm (rërë kuarci). Pra është një sipërfaqe me shtresë të trashë të shkëlqyer e cila përbëhet nga dy komponente, nivelizuese në bazë epoxide dhe me nuancë nga karta e ngjyrave për dysheme RAL; Me qëndrueshmëri të madhe nga ndikimet e abrazionit si dhe ato të kemikaleve. 3. Estrih i armuar Q64 t=5cm, 4. Bëhet shtrirja e masës transparente me StoPur WV200.5. Në fund, lyerje e gjithë sipërfaqes me StoDivers P 120, një material i cili mundëson mbrojtjen dhe mirmbajtjen më të lehtë të pastërtisë në dysheme. vërejtje: Në çmim të parashifen edhe këndoret perimetrike nga vet prodhuesi i dyshemesë. Ngjyra të përcaktohet nga projektanti.	m²	3200	13.0	41,600.00
	gjitheshej pere dyshemet "NORA PLAN"				41,600.00

INVESTITOR : MINISTRIA E KULTURES RINISE DHE SPORTEVE

11	Pllatote dhe trotuaret				
	<i>Furnizimi dhe vendosja e kubzave nga betoni t=8 cm të trotuareve dhe rrugicava mbrenda kompleksit , prej pllakave te tulles me perkufizim te granitit te pa perpunuar dhe formojn katrore 75/75cm ,traka e granitit eshte 15cmgjersi e saj ndersa d=8cm, të gjitha materialet para se të vendosen bëhet përzgjedhja nga investitori.</i>				
	suteren	m ²	1850	8.00 €	14,800.00
	gjitheshej pere pllakosjen e trotuareve dhe pllatove				14,800.00




Horina

12	renderimi i mbrendeshem				
12.1	Furnizimi dhe suvatimi i siperfaqeve te mureve me llaq te gatshem duke e perfshire edhe gletimin				
	sutereni	m ²	1200	10.00 €	12,000.00
	perdhesa	m ²	350	15.00 €	5,250.00
	kati 1	m ²	120	20.00 €	2,400.00
12.2	Ngjyrosja e mureve me dy shtresa ngjyre e cila percaktohet nga organi mbikqyres.				
	sutereni	m ²	1200	3.00 €	3,600.00
	perdhesa	m ²	350	3.00 €	1,050.00
	kati 1	m ²	120	3.00 €	360.00
	gjithesej pere renderimin e mbrendshem				24,660.00
15	Furnizimi dhe montimi duke përfshir edhe punët finale të elementet montuese te sanitarive edhe te kabinave te tyre				
15.o	Furnizimi dhe punimi, Ndarja e WC kabinave edhe tush kabinave behet me sistemin K32 Icon Cubicles me lartesi te elemen. H=2m te vendosura mbi niveline dyshemese pere 150mm me mbajtes rosfa i dyer integruese me qels nga ana e mbrendeshme dhe konstrukcion pere shtangimin e elementeve ,konstruksini perkates i metalit . Nuk lejohet ne asnje menyre mediapani apo plastika.	m2	320	50.00 €	16,000.00
15.1	Furnizimi dhe vendosja lavamane te sistemit K32 Corian Vanity top me trashesi te siperfaqes horizontale d=75mm mbajtes prej çeliku ne mure si dhe legen oval me rubineta	cop	46	40.00 €	1,840.00
15.2	Furnizimi dhe montimi i uleseve me elemente druri me prerje terthore 80x50 .Uleset duhet te jene me gjeresi 35cm dhe gjatesi 3.3m	cop	8	50.00 €	400.00
15.2	Furnizimi dhe montimi i uleseve me elemente druri me prerje terthore 80x50 .Uleset duhet te jene me gjeresi 35cm dhe gjatesi 1.5m	cop	4	50.00 €	200.00
15.4	Furnizimi dhe montimi i pasqyrave ne nyjet sanitare te vendosura ne mure dhe dimensionet jane sipas siperfaqes qe zene lavamanet , lartesia e te vendosurit te pasqyreve eshte h=1.155 , ndersa lartesia e vete pasqyres eshte h=1m				
	sanitarite e sportistev	m ²	15		
	sanitarite e publikut	m ²	28		
	sanitarite e vequera	m ²	6		
	gjithesej		49	10.00 €	490.00
15.5	mbajtesit e toalet let.te vendosura ne mure	cop	52	1.00 €	52.00
15.6	mbajtesit e teresit te duarve te montuara ne mure	cop	28	1.00 €	28.00
15.7	mbajtesit e sapunit te duarve	cop	28	1.00 €	28.00
	gjithesej pere elem.montuese te sanitarive				19,038.00

17	gardhi I shkalleve edhe ndarjes ne mes te fushes se lojes edhe publikut me profila metalik me dimensione $\varnothing 63 \times 3 \text{mm}$, ngjyrosja me ngjyre baze dhe dhe dy here ngjyre vajore sipas detalit në projekt.	m'	120	100.00 €	12,000.00
	GJITHSEJ PUNET E KARRIGEVE DHE GARDHIT				12,000.00
18	Furnizimi dhe montimi me të gjitha elementet e nevojshme sistemi ARMSTRONG ose të ngjashme.				
18.o	pllfonet jane te leshuera te parapara ne zyre holle dhe byfe jane prej sistemit "ARMSTRONG" d=12mm fiberglass materjali	m ²	1100	14.00 €	15,400.00
18.1	pllafoni I leshuar ne salle ne pjese etribunave kryesore eshte nga sist."ARMSTRONG" metal Alumnium me konstruksionin perkates	m ²	1450	1.00 €	1,450.00
	<i>gjithesej pere sist.ARMSTRONG</i>				16,850.00
19	Furnizimi dhe montimi I dyerve Hörman ose ekuivalente duke përfshir edhe materialet e imta si dhe dorezen me cilinder,dimensionet edhe pse jan të cekura duhet të maten në vend.				
19.1	dyert e mbrendeshme (intrnale) qe sipas pozites se tyre dhe dimensioneve jane keto:				
	D-garderob.sport	0.90/2.10	10	300.00 €	3,000.00
	Dyer nga alumini per nyjet sanitare	0.80/2.10	22	300.00 €	6,600.00
	D-terasa	2.31/2.10	5	500.00 €	2,500.00
	D-publikut	2.4/2.10	10	500.00 €	5,000.00
	Dyert per depo	0.9/2.10	7	300.00 €	2,100.00
	<i>gjithesej pere dyer te sistemit Hörman</i>				19,200.00
	Totali I puneve ndertimore				408,608.00

Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet pas përfundimit të tërësisëm të pozicionit



Handwritten signature

PARAMASA - INSTALIMI I NDRIÇIMIT TË SALLES SË SPORTEVE**VEREJTJE:**


Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.

NR.	PËRSHKRIMI I MATERIALIT	NJËSIA	SASIA	Ç/NJ	SHUMA
1	Furnizimi dhe montimi I ndriçuesve industrial HERO-6000-865 SF -ND (0657482) i prodhuar nga alumini i presuar me lentë optike 110 ° (super-flood lens optics) Dizajni: Ndriçues industrial LED për montim në sipërfaqe të tavanit ose për varje në tavan më mbrojtje IP64. Shtepiza, kompakt, i përbërë profilet e aluminit, të bardha, të veshura me pluhur, ngjyrë të ngjashme me RAL 9016. Trupi ndriçues: Struktura e përbërë nga profilet e veçanta të aluminit me pllaka të forta ftohëse , për qarkullimi termik të ajrit i cili garanton menaxhimin optimal të nxehtësisë për nivele të larta të fluksit të ndriçimit. Kontroll optik duke përdorur vargjet e lenteve të pajisura me LED për efikasitet të ndriçimit maksimal. LED_i: I pajisur me nano-mveshje për rritjen e rezistencës ndaj gazrave korrozive. Lenta: E mbyllur nga paneli i tejdukshëm nga materiali PMMA. Klasa e sigurisë: Klasa I. Ndikimi i rezistencës IK04. Rezistent ndaj goditjeve të topit. Balast elektronik për LED, 220-240V, 0 / 50-60Hz. Ngjyrat e renderimit me indeksin Ra> = 80, ngjyra e temperaturës (4000 Kelvin (840) Standardet e aplikueshme: DIN 18032, Pjesa 3 të testuara sipas kërkesave të MPA ose VDE. Ndriçues: 19x LED-M 30W. Fluksi i ndriçimit 57200lm. Klasa e mbrojtjes: IP 64. Klasa e mbrojtjes: I Dimensioni: LxWxH = 1197x372x109. Peshë : 24kg	copë	44	200	8,800.00
